



---

REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONKURUESHMËRISË DHE PARTNERITETIT  
DREJTORIA E TREGUT TË BRENDSHËM

---

---

### **Besushmeri ne Tregun Shqiptar dhe në atë Ndërkombetar**


---

*Akreditimi është një funksion mjaft efektiv në treg ku blerësit dhe shitësit janë në një marrëdhënie të sigurt dhe besueshmërie në produktet dhe shërbimet që ofrojnë dhe marrin.*

**Numri total i organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar janë 46 nga të cilët:**

26 laboratorë testues; 3 laboratorë mjekësorë; 1 laborator kalibruar; 10 organe inspektuese; 3 organe certifikuese të sistemit të menaxhimit; 3 organe certifikuese të personelit

## Rritja e Nr për aplikim për Akreditim



### Anëtarësimi në EA

Që nga viti 2001, DPA ishte anëtare shok në Organizmin Evropian të Akreditimit. Me marrjen e statusit të vendit kandidat, DPA në Janar 2015, aplikoi për tu bërë anëtar me drejta të plota në EA. Pas vlerësimit të të gjithë dokumentacionit teknik të dorëzuar, EA vendosi që DPA plotëson të gjitha kriteret për marrjen e statusit të anëtarit me drejta të plota. Ky vendim u mor në Asamblenë e Përgjithshme të EA në Athinë në Maj 2015.

### Anëtari EA-MLA

DPA plotëson kërkesat dhe bëhet **anëtar firmosës i EA-MLA** në fushën e testimi. Në Nëntor 2015, DPA firmosi Marrëveshjen e Njohjes Reciproke me EA në Asamblenë e Përgjithshme të saj që u mbajt në Budapest. Gjithashtu u vendos që vlerësimi tjetër i radhës do të jetë në fillim të vitit 2017 (aplikimi është bërë dhe për inspektimin dhe certifikimin). Njohjen reciproke me vendet e BE -se për laboratorët testues duke i hequr kështu barrierat teknike në lidhje me këtë fushë duke i krijuar lehtësira biznesit në Shqipëri (certifikata e lëshuar nga DPA i njihet në vendet e Evropës)

### Marrja e ILAC-MRA

Pas firmosjes së EA-MLA në fushën e testimi, DPA aplikoi për marrjen e ILAC-MRA në fushën e testimi. Në 16 Maj 2016, Organizata Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve pranoi kërkesën e DPA dhe i dha asaj statusin e organizmit firmosës së ILAC-MRA në fushën e testimi dhe anëtar me drejta të plota në fushën e testimi ku njohja nuk do të jete vetëm në vendet e Evropës